


# Bashkia Lezhë



## Raporti Performancës 2021



### Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2021 të Bashkisë Lezhë.

[Lezhë - Raporti i Performancës 2021 | Tableau Public](#)

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Lezhë me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

## **Përmbajtja**

<b>Fjalor shpjegues .....</b>	<b>3</b>
<b>Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021.....</b>	<b>4</b>
<b>Burimet e Financimit.....</b>	<b>5</b>
<b>Shpenzimet buxhetore .....</b>	<b>6</b>
<b>Investimet.....</b>	<b>7</b>
<b>Administrimi i bashkisë.....</b>	<b>8</b>
<b>Planifikimi urban .....</b>	<b>10</b>
<b>Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara.....</b>	<b>12</b>
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor .....</b>	<b>13</b>
<b>Furnizimi me ujë.....</b>	<b>15</b>
<b>Rrjeti rrugor rural.....</b>	<b>17</b>
<b>Kujdesi social për familjet dhe fëmijët .....</b>	<b>21</b>

## **Fjalor shpjegues**

### **Taksat e ndara**

Janë taksa kombëtare që mbliidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë.

### **Tasat vendore**

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak.

### **Tarifat vendore**

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia.

### **Transfertat e kushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë.

### **Transfertat e pakushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi.

### **Transfertat specifike**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë.

### **Trashëgimi nga viti kaluar**

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

**Tregues të performancës së programeve buxhetore.** Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullësor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

### **Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre**

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



### Bashkia Lezhë

Bashkia Lezhë arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë kanë pësuar rënie. Turizmi si sektori më i rëndësishëm i bashkisë ka ndjerë rënien e numrit të turistëve e për rrjedhojë hoteleria, dhe gjithë shërbimet mbështetëse. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë bizneset e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Turizmi edhe pse me ndikimin më të thellë ekonomik duke u krahasuar me vitin 2020 kur pothuajse u mbyll totalisht e rimori disi veten falë kjo edhe prej shqiptarëve të Kosovës të cilët në mënyrë tradicionale tashmë, zgjedhin prej disa dekadash Shëngjinitin si destinacion turistik. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Bizneset në një masë të konsiderueshme ndaluan punën tërësisht ose përkohësisht për t'iu adaptuar kushteve të reja pandemike. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim dhe shërbime e për rrjedhojë rënien e fitimit të cilat çuan në rënien e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore që mbledh bashkia. Ky efekt u reflektua në totalin e të ardhurave të veta të bashkisë të cilat edhe pse janë rritur me rreth 60% kundrejt vitit 2020 ato janë ende sa gjysma e të ardhurave të grumbulluara në vitin 2019.

Një buxhet në rritje i bashkisë vjen për shkak të mbështetjes nga qeveria qendrore e cila ka rritur me rreth 45% kontributin e saj kundrejt vitit 2020 një kontribut çdo vit në rritje ky, kryesisht për shkak të projekteve të rindërtimit të banesave të komunitetit dhe institucioneve publike që u prishën nga tërmeti i dhjetorit 2019.

Është për t'u theksuar se edhe gjatë vitit 2021 bashkia ashtu sikurse një vit më parë i ka ardhur në ndihmë familjeve të dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë përfitur bonos (grant për qeranë e përkohshme) si edhe ndërtimin e banesave apo apartamenteve si financim nga qeveria qendrore nëpërmjet bashkisë.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:




- ✧ Dyfishimi i peshës së investimeve dhe rënia peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✧ Mbështetje me shërbime sociale duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë
- ✧ Ruajtjen e numrit të personelit të bashkisë dhe gjithë institucioneve të bashkisë
- ✧ Rritja e peshës së të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë por ende larg asaj të para-Pandemisë.

Ekzekutimi i buxhetit nuk ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, për shkak të shumë projekteve me financim të qeverisë qendrore, të cilat do të vazhdojnë të zbatohen përgjatë vitit 2022.

# Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	<b>2,064,181</b>	<b>2,217,625</b>	<b>3,742,607</b>	<b>3,911,050</b>	<b>96%</b>

Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Viti 2021 në %
<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>	Të ardhura nga taksat e ndara	43,786	59,149	69,974	39,150	<b>179%</b>
	Të ardhura nga taksat lokale	496,782	130,332	254,040	402,466	<b>63%</b>
	Të ardhura nga tarifa vendore	136,607	123,689	171,663	196,795	<b>87%</b>
	Të ardhurat e tjera	23,333	23,661	39,437	65,146	<b>61%</b>
<b>TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR</b>	Transferta e kushtëzuar	556,914	1,140,872	1,537,544	1,537,544	<b>100%</b>
	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	163,608	85,824	411,200	411,200	<b>100%</b>
	Transferta e pakushtëzuar	320,802	340,522	350,062	350,062	<b>100%</b>
	Trasferta specifike	195,466	202,693	226,493	226,493	<b>100%</b>
<b>TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR</b>	Trashëgimi nga viti i shkuar	126,883	110,883	682,194	682,194	<b>100%</b>




Pesha e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë ende modeste.

Rikthimi disi i normaliteti nga gjendja e pandemisë bëri që ardhurat nga burimet e veta të rriten krahasuar me një vit më parë. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✳ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 69% kundrejt vitit 2020 në masën 76% të planit për vitin 2021
- ✳ Pesha e të ardhurave të veta (taksat dhe tarifat) në total burime financimi është 14% dhe transfertat e qeverisë është 68%
- ✳ Të ardhurat e veta u rritën me 59%
- ✳ Të ardhurat e qeverisë u rritën me 43%
- ✳ Fondet e investimeve të financuara nga qeveria qendrore u katërfishuan
- ✳ Realizimin më të ulët e kanë taksat dhe tarifat vendore kundrejt planit 2021

# Shpenzimet buxhetore




## Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rritje kundrejt vitit 2020 me 42%, duke reflektuar kështu grantin për rindërtim të dëmtimeve të tërmetit dhjetor 2019, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 77.5%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga furnizimi me ujë, ujitja e kullimit, e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim pothuajse tërësisht sipas planit e kanë shërbimet që kanë një financim nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ *Planifikimi urban*
- ✿ *Furnizimi me ujë*
- ✿ *Kujdesi social për PAK*
- ✿ *Rrjeti rrugor*
- ✿ *Administrimi*
- ✿ *Kujdesi social për familjet dhe fëmijët*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*

# Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	<b>481,626</b>	<b>391,111</b>	<b>1,183,915</b>	<b>1,636,672</b>	<b>72.3%</b>




## Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond rreth 1.2 miliardë lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet janë rritur me rreth 3.5 herë, kjo shpjegon rritjen e kontributit të tyre në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2020 kundrejt planit është në masën 72.3%.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2021 kanë shënuar një hap cilësor në menaxhimin financiar:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2021 rreth 39% të buxhetit të bashkisë nga 16% në vitin 2020
- ✿ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: Rikonstruksion i baneve të dëmtuara nga tërmeti, përmirësimi i infrastrukturës rrugore, sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm në 5 fshatrat e Njësisë Administrative Zejmen dhe të zonës bregdetare në Njësinë Administrative Shënkoll, Rikonstruksioni i Kanalit Ujitëse Kotërr - Rabosht, Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare At Zef Pëllumbi Shëngjin, Rikonstruksion i Konviktit të Shkollës Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” në Lezhë, dhe shumë e shumë projekte të tjera investimesh.

# Administrimi i bashkisë



Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korrente dhe investim

## Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↓	Numri i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	4.0	16.4	18.5	0.0
↑	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar)	89	-99	-6	0.0
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	2.0	1.0	5.0	5.0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total	110	47	125	150
Numri total i personave të trajnuar	55	47	25	30



Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fondi vjetor i pagave të punonjësve në total të bashkisë (në mijë lekë)	540,233	458,504	488,537	538,775
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	129	30	24	24
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	35	120	140	0
Numri total i punonjësve në njesite shpenzuese	135	88	94	94
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	605	459	485	480
Numri total i punonjësve të bashkisë	876	730	756	751
Shpenzime korente (në mijë lekë)	179,494	111,440	120,704	130,927
Shpenzime për investime (në mijë lekë)	3,454	120	3,154	7,398

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 89.5% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 4.1% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2021 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përkrah të tërmetit dhe pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:


- ✱ Është përmirësuar respektimi i kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës. Janë marrë më pak masa disiplinore për punonjësit e bashkisë;
- ✱ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë;
- ✱ Është krijuar një tendencë paqendryeshmërie në radhët e nëpunësve të bashkisë si rrjedhojë e rritjes së punonjësve që kanë lëvizur nga puna.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
<b>Administrimi i bashkisë</b>	<b>3,454</b>	<b>1200</b>	<b>3,154</b>	<b>7,398</b>	<b>43%</b>
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Blerje 3 automjete për Policine Bashkiake, IVMT dhe Tatimet	4,200				
Blerje autoveture për aparatin e bashkisë	3,216				
Blerje kompjuterike për aparatin e bashkisë dhe MZSH	495	169	0	2,150	0%
Blerje pajisje për Drejtorin e Integritetit (kamera, aparat fotografik etj)	0	0	0	750	0%
Blerje pajisje kondicionimi			1,186	1,200	99%
Blerje pajisje për Zyrën e Shtypit			648	648	100%

Blerje pajisje zytrash			380	500	76%
F/V kamera në Sallën e Mbledhjeve të këshillit			98	98	100%
F/V Tripod barrier			310	350	88.5%
Rikonstruksion i Z1N			1,181	1,200	98%
Rikonstruksion i Zyrave te ish - Banka Tregtare			0	2,000	0%

## Planifikimi urban

<b>Realizimi faktik 2021</b>	<b>Vlera në mijë lekë</b> 755.899	<b>Pesha në buxhet</b> 24.9%	<b>Realizimi Faktik 2021</b> 63.8%
------------------------------	--------------------------------------	---------------------------------	---------------------------------------



Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi urban: korente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Planifikimin dhe zhvillimin i banesave të përshtatshme për komunitetin

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Inventari i instrumentave të përdorur nga bashkia si: PPV; Plani detajuar zonale; Plani sektorial për shembull për menaxhimin e integruar të mbetjeve etj. (ndryshimi vjetor i numrit të instrumentave)	-1	0	2	2
↓	Numri lejeve të miratuara të zhvillimit që përputhen me planet e detajuara të zhvillimit kundrejt numrit total të lejeve të miratuara (në %)	57.1	50.0	38.5	42.9
↑	Raporti i të ardhurave nga lejet e zhvillimit të miratuara kundrejt totalit të të ardhurave të bashkisë (në %)	56.3	9.3	24.9	40.1

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Instrumentat e planifikimit që përdor bashkia PDV	20	20	22	20
Numri lejeve të miratuara të zhvillimit që përputhen me planet e detajuara të zhvillimit	400	300	250	300
Numri total i lejeve të zhvillimit të miratuara nga bashkia	700	600	650	700

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Të ardhurave nga lejet e zhvillimit (në mijë lekë)	394,298	31,270	133,225	282,451
<b>Totali i të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë (në mijë lekë)</b>	<b>700,508</b>	<b>336,831</b>	<b>535,114</b>	<b>703,557</b>

## Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimeve të urbanistikës duke hartuar, përditësuar dhe monitoruar planet e zhvillimit të territorit. Për këtë ajo harxhuar një buxhet në masën 755,899 mijë lekë të alokuara në rreth 64% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 24.9% të buxhetit të saj për urbanistikën, një peshë e rritur përgjatë dy viteve të fundit për shkak të projekteve të rindërtimit të institucioneve publike dhe banesave të qytetarëve prej pasojave të tërmetit 2019.

Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:


- ✿ Përfundimi i rindërtimit të banesave në bashkëpronësi dhe individuale për strehimin e familjeve, banesat e të cilave janë dëmtuara si pasojë e tërmetit.
- ✿ Ulja e numrit të lejeve të ndërtimit që përputhen me planin urban, kjo si pasojë e projekteve të rindërtimit të cilat janë plane emergjence
- ✿ Rritjen e të ardhurave nga taksat për lejet e zhvillimit
- ✿ Zvogëlimi i instrumentave të planifikimit si pasojë e afrimit të periudhës së vlefshmërisë për ato instrumenta që janë hartuar me kohë të cilat parashikohen të azhurnohen përgjatë vitit të ardhshëm.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
<b>Planifikimi urban</b>	<b>1,400</b>	<b>53,876</b>	<b>313,259</b>	<b>485,822</b>	<b>64%</b>
Në mijë leke					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Hartimi i 24 Planeve të Detajuara vendore			9,748	12,374	<b>79%</b>
Hartimi i projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese në banesave të dëmtuara nga termeti		53,876	9,508	21,431	<b>44%</b>
Riforcimi i njësisë të banimit, ndërtesave dhe pallateve të dëmtuara nga termeti			293,997	319,992	<b>92%</b>
Rikonstruksion banesash individuale dhe njësisë të banimit të dëmtuara nga termeti			0	94,189	<b>0%</b>

Rikonstruksion i banesave individuale, njësjive të banimit dhe mjediseve në bashkëpronësi			0	89,027	0%
---	--	--	---	--------	----

## Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

<b>Realizimi faktik 2021</b>	<b>Vlera në mijë lekë</b> <b>493,626</b>	<b>Pesha në buxhet</b> <b>16.3%</b>	<b>Realizimi Faktik 2021</b> <b>99.4%</b>
------------------------------	---	--	--



Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: korrente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Rritja ose përmirësimi i skema apo institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Numri shërbimeve të ofruara për persona PAK në shtëpi (Ndryshimi vjetor në numer)				
↓	Perfitimi monetar (në mijë lekë) për persona të sëmurë dhe PAK	103.9	110.0	105.9	106.5
○	Persona me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale (Ndryshimi vjetor në numer)				
↓	Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti (Ndryshimi vjetor në numer)	274	88	-32	0
○	Shpenzimet totale në qendrat e shërbimeve PAK kundrejt numrit total të personave të akomoduar në këto qendra (Mijë Lekë/Person)				

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti	4,607	4,695	4,663	4,663
Numri i personave me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale për personat PAK				
Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzime totale për qendrat rezidenciale PAK (në mijë lekë)				
Shpenzimet totale për mbështetjen e personave PAK (në mijë lekë)	478,678	516,814	493,626	496,635

## Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 99% kundrejt planit 2021. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 16% të buxhetit të saj.

Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për personat e sëmurë dhe me afatësi të kufizuara:

- ✱ Më pak persona të mbështetur me pagesë invaliditeti
- ✱ Mesatarisht më pak para për person në vit të mbështetur
- ✱ Është ruajtur numri i shërbimeve për personat që u ofrohet shërbimi në shtëpi.

## Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha në buxhet	Realizimi Faktik 2021
	<b>399.362</b>	<b>13.2%</b>	<b>93.1%</b>



Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korrente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor:

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	77	77	100	100
↑	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	12	12	11	12
↑	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	18	18	17	18
↑	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (në mijë lekë / institucion)	4,135	2,880	6,886	7,397

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	80	81	81	81
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	350	350	350	350
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	60	58	58	58

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	1,573	1,470	1,500	1,470
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	2,045	1,911	1,500	1,470
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	497	449	534	522
Mësues në sistemin parashkollor	94	97	97	97
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	526	526	526	526
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	6,339	6,216	5,924	6,215
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë (në mijë lekë)	248,101	167,050	399,362	429,048

### Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor, pagesën e edukatoreve të kopshteve dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 93.1% të planit 2021. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mësuesve të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 13.2% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

✱ Është rritur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;


- ✳ Është ulur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- ✳ Është dyfishuar niveli i buxhetit të alokuar për një institucioni arsimor si rrjedhojë e fondeve të investimeve për rikonstruksionin e disa ndërtesave arsimore të prekura nga tërmeti i dhjetorit 2019.

Investimet e realizuara përgjatë viteve synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve. Investimet u realizuan në masën 96.5% të planit, me një fond total 226 milionë lekë deri në fund të dhjetorit 2021.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
<b>Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor</b>	<b>78,884</b>	<b>4,883</b>	<b>225,984</b>	<b>234,093</b>	<b>97%</b>
Në mijë leke					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje bolieri dhe lavatriçe për kopshte e çerdhe	219		68	68	100%
Blerje krevatë dhe karrike për kopështet			116	116	100%
Blerje paisje të buta për kopshtet	888		464	582	80%
Blerje pompë uji dhe pompe zhytëse për kopshtet		147	78	78	100%
Blerje soba per ngrohje per shkollat		947	58	909	6%
F/V Vendosije kamera sigurie ne shkolla	2,148		107	107	100%
Ndërtim Kopështi të Fëmijëve Lezhë	50,843		2,578	2,578	100%
Ndërtim Palestre shkolla 9 vjeçare lagjia "N.Tereza"	23,998				
Ngurtësim fondi Kopshti "Gurra"		909			
Rikonstruksion i Shkollës 9 vjeçare Manati			2,518	2,544	99%
Rikonstruksion Kopështi në lagjen "Gurra"	18,179				
Rikonstruksion kopshti ne fshatin Merqi					
Rikonstruksioni Palestres shkolles 9 vjeçare N.Tereza Lezhe			0	5,000	0%
Rindërtim i Shkollës 9 vjeçare "At Zef Pëllumbi", Shëngjin			220,065	226,500	97%
Riparim kapital i kaldajave në shkolla			0	582	0%
Studim projekte për shkollat 9 vjeçare Shëngjin dhe Ishull Shëngjin		2,880			

## Furnizimi me ujë

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë lekë	Pesha në buxhet	Realizimi Faktik 2021
	<b>379.063</b>	<b>12.5%</b>	<b>99.7%</b>



Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

#### Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Orë ujë në ditë (Ndryshimi ditor në orë)	0.64	0.00	0.70	-0.50
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	80.00	80.00	80.07	80.00
Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (përfshirë investime dhe amortizimi) (në %)				
Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzime korente (në %)				

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (orë në ditë-natë)	21	21	22	22
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	52,506	52,506	52,550	52,506

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) në mijë lekë				
Popullsia totale e bashkisë	65,633	65,633	65,633	65,633
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm në mijë lekë				
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm në mijë lekë				



## Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë tërësisht sipas planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 12.5% të buxhetit të saj për ofrimin e ujit të pijshëm për komunitetin duke synuar zgjerimin e mbulimit me shërbim në të gjitha fshatrat e njësisë të saj administrative. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë. Aktualisht uji i pijshëm ofrohet nga UK Lezhë, shërbim ky që synon të mbulohet nga tarifat e aplikuara për konsumatorët familjarë, institucione dhe biznese. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✱ Rritjen e nivel të mbulimit me ujë të pijshëm të familjeve dhe bizneseve dhe vazhdimin e punës për të futur në skemën e furnizimit me këtë shërbim edhe të familjeve që nuk e aksesojnë deri më sot
- ✱ Më shumë territor është mbuluar me furnizimin e ujit të pijshëm
- ✱ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët me rreth 1 orë ujë të pijshëm më shumë në ditë.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
<b>Furnizimi me ujë</b>	<b>24,563</b>	<b>74,584</b>	<b>379,063</b>	<b>380,000</b>	<b>100%</b>
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Bashëfinancim ujësjellësi në fshtrat Kallmet i Madh dhe i Vogel		7,924			
Furnizim me ujë të zonës bregdetare të Nj.Administrative Shënkoll, Lezhë			189,954	190,000	<b>100%</b>
Ndërtim Ujësjellësash në fshtrat e njësisë administrative Zejmen		60,390	189,109	190,000	<b>100%</b>
Ndërtim Ujësjellësash në fshtrat Troshan dhe Fishtë	24,561				
Oponencë teknike për 5 ujësjellësat e fshatrave në Nj.Administrative Zejmen		306			
Studim projektive për ujësjellësat e fshatrave Zejmen		5,964			

## Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë lekë	Pesha në buxhet	Realizimi Faktik 2021
<b>Realizimi faktik 2021</b>	<b>233,043</b>	<b>7.7%</b>	<b>56%</b>



Kategorië e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërlokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Raporti i rrugeve te asfaltuara ndaj totalit te rrugeve (te asfaltuara, cakull etj) ne %	30	9	14	14
→	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
→	Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
→	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
→	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
→	Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
→	Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
↓	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në mije lekë për 1 km rrugë rurale	84	47	159	161
↓	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në mijë lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	368	138	250	446
↓	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në mije lekë për 1 km rrugë urbane	1,811	598	712	1,895

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 56% të planit 2021 në një vlerë prej mbi 233 milionë lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 55% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 7.7% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✿ Është rritur rrjeti i asfaltuar, ai përfaqëson rreth 14% të totalit të rrjetit rrugor
- ✿ Janë ulur aksidentet rrugore;
- ✿ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✿ Është rritur kosto mesatare e 1 km linear rrugë të mirëmbajtur, kjo për shkak të përmirësimeve të mëdha në rrjet të cilat janë pothuajse rindërtime nga e para e sistemit rrugor.


Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	932.4	932.4	932.4	932.4
Rrugë rurale të mirëmbajtura	779.2	779.2	779.0	779.2
Rrugë urbane të mirëmbajtura	153.2	153.2	153.0	153.2
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	279.6	86.5	134.1	134.1
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	249.3	76.4	105.8	105.8
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	30.3	10.1	28.3	28.3

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	932	932	932	932
Rrjeti rrugor urban	153	153	153	153
Rrjeti rrugor rural	779	779	779	779
Numri aksidenteve rrugore (këmbësorë + automjete)				
Numri i aksidenteve të automjeteve				
Numri i aksidenteve të këmbësorëve				
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë lekë	343,030	128,542	233,043	415,572
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin rural në mijë lekë	65,663	36,988	124,149	125,300
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin urban në mijë lekë	277,367	91,555	108,894	290,272

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Rrjeti rrugor rural	<b>277,367</b>	<b>91,555</b>	<b>163,741</b>	<b>328,494</b>	<b>50%</b>
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Asfaltim rruges varrezave ne fshatrat Mabe dhe Zojs	5,150	0	258	258	100%
Blerje automjtesh (ngurtësim fondi)			869	869	100%
Blerje fadrome me goma.	0	3,690			
Blerje fadrome të vogël		1,771			

Likujdim fondesh per Mbikeqyrje dhe Kolaudim punimesh për investime	3,123				
Ndërtim murimbajtës të rrugës Kalasë Lezhë	16,446		822	822	<b>100%</b>
Ndërtim stacione urbane ne fshatin Kolsh, Manati dhe Barbulloje	0				
Ndërtim ure në fshatin Mabë	7,854				
Ndërtimi i 2 urave mbi lumin Drin, Lezhë dhe rehabilitim i shëtitores			5,841	65,350	<b>9%</b>
Rikonstruksion asfaltim rruga e Myltes fshati Rrilë	39,537				
Rikonstruksion i rruges Fregen - Kalivaç	838				
Rikonstruksion rrugësh lagjja "Besëlidhja"	9,886		4,160	4,160	<b>100%</b>
Sistemim bllok dhe rrugësh tek pallatet e Gjok Nikës, në lagjen "Besëlidhja", Lezhë		3,819			
Sistemim dhe asfaltim rrugë rurale		54,207	116,012	119,324	<b>100%</b>
Sistemim, asfaltim të rrugëve të brendshme në fshatin Kotërr	20,039				
Supervizim dhe mbikëqyrje punimesh		1,064			
Vazhd.inv. "Sist.& asfaltim i rruges Q.Kakarriq - Gocaj dhe ndriçim qendres fsh.Kakarriq"			186	3,297	<b>6%</b>
Vazhdim Inv. "Riveshje dhe asfaltim rruge qënder e fshatit Rrilë - shkolla 9 vjeçare Rrilë"	0		1,571	2,858	<b>55%</b>
Vazhdim inv. "Sistemim, asfaltim i rrugës Azem Hajdari në fshatin Ishull Shëngjin"	12,888	688	4,511	12,147	<b>37%</b>
Vazhdim inv. "Sistemim, asfaltim i rrugës Çamëria, aksi rrugor për tek Bordi i Kullimit"	5,500		0	4,573	<b>0%</b>
Vazhdim inv. "Sistemim, asfaltim i rrugës shkollë lagjja e Pukjanëve në fshatin Grykë Lumi"	3,811		233	802	<b>29%</b>
Vazhdim inv. "Sistemim, asfaltim rruge te brendshme ne fshatin Troshan, Nj.Ad.Blinisht"	5,000	2,000	2,088	2,088	<b>100%</b>
Vazhdim inv. "Sistemim, asfaltim të rrugës Kolin Gjoka Qënder Ola - tuneli i lagjes N.Tereza	8,690		6,819	6,819	<b>100%</b>
Vazhdim investimi "Rikonstruksion i rrugës Luigj Gurakuqi (Prokurori-Ura e Cenit)"	2,317				
Vazhdim investimi "Rikonstruksion i rrugës në lagjen Zallë NJ.Ad.Shënkoll"	3,500	1,500	4,391	4,391	<b>100%</b>
Vazhdim investimi "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në lagjen e Spitalit"			0	344	<b>0%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim & asfaltim i rrugës Rraboshtë - Shkolla 9 vjeçare Rraboshtë"	4,775	1,497	0	1,288	<b>0%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim & asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatin Tresh"	2,600	0	5,389	5,389	<b>100%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim blloku në lagjen "Besëlidhja", Lezhë, tek Drejtoria e Tatimeve"	7,000				
Vazhdim investimi "Sistemim dhe asfaltim i rrugës varrezave në fshatin Pllanë"	2,448	4,932	1,614	1,614	<b>100%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim i ambientin përballë pallatit nr.28, lagjia Besëlidhja Lezhë"			1,200	1,200	<b>100%</b>
Vazhdim Investimi "Sistemim i rruges varrezave ne fshatin Balldre i Ri"	5,500		2,270	2,270	<b>100%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim, asfaltim aksi rrugor dhe trotuare Superstrate - Piraj"	8,000		0	2,640	<b>0%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim, asfaltim i aksit rrugor Mabë - Barbullushë"	3,716				
Vazhdim investimi "Sistemim, asfaltim i rrugës Tale 1 - Tale 2, Nj.Ad.Shënkoll"		13,907	754	18,316	<b>4%</b>
Vazhdim investimi "Sistemim, asfaltim rrugë të brendshme në fshatin Gramsh"	7,988		0	1,558	<b>0%</b>
Vazhdim investimi "Sistemimi i rrugës Hydajet Lezha, përballë hotel Letit"		1,465	0	398	<b>0%</b>
Asfaltim rruges varrezave ne fshatrat Mabe dhe Zojs	5,150	0	258	258	<b>100%</b>

# Kujdesi social për familjet dhe fëmijët



Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korrente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
➔	Familjeve ne nevojë te mbeshtetura (Ndryshimi vjetor në numer)	-3	44	-4	0
➔	Fëmijë pa përkujdes prindëror që kanë përfituar nga shërbimet e shërbimit social (Ndryshimi vjetor në numer)	-4	0	0	0
➡	Fëmijë që kanë përfituar nga shërbimi në qendra sociale dhe rezidenciale (Ndryshimi vjetor në numer)	-4	0	14	0
⬇	Gra viktimat të dhunës në familjet të trajtuara me mbështetje (Ndryshimi vjetor në numer)	0	40	-36	0
➔	Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale (Ndryshimi vjetor në numër)	0	0	0	0
➔	Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të shërbyer gjithsej ne qendrat sociale	0	0	0	0
Fëmijë të shërbyer në Qendra ditore	116	116	116	116
Fëmijë të shërbyer në Qendra rezidenciale	0	0	0	0
<b>Familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetura nga bashkia</b>	41	85	85	85
Fëmijë pa kujdes prindëror që kanë marrë kujdes nga bashkia	8	8	7	7
Viktima të dhunës në familje dhe / ose viktima të trafikuar të mbështetura nga bashkia	25	31	29	29
<b>Fëmijë të shërbyer në kopshte dhe çerdhe</b>	1,689	1,586	1,596	1,630
Fëmijë në çerdhe	116	116	116	130
Fëmijë në kopshte	1,573	1,470	1,480	1,500
<b>Numri i çerdheve funksionale</b>	0	0	0	0
Çerdhe	1	1	1	1
<b>Numri personave të mbështetur me ndihmë ekonomike</b>	978	964	960	960

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për familjet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 92.7% kundrejt planit 2021.

Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 4.4% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë si :

- ✿ Familje dhe fëmijë në nevojë
- ✿ Fëmijë pa kujdes prindëror
- ✿ Fëmijë në qendra ditore
- ✿ Gra dhe fëmijë viktima të dhunës
- ✿ Fëmijët e shërbyer në çerdhe dhe kopshte

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
<b>Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët</b>	<b>2,020</b>	<b>0</b>	<b>1,448</b>	<b>1,450</b>	<b>100%</b>
Në mijë lekë					
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakti 2019</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>
Blerje automjeti			870.0	870.0	100%
Blerje enë kuzhine dhe pajisje te buta për çerdhen	114.0				
Blerje krevatë dhe karrike për çerdhen			510.0	510.0	100%
Blerje lavatriçe për çerdhen			68.0	70.0	97%